



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
**Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes, Financimit dhe**  
**Monitorimit**

**NJOFTIM**

**PËR TË APLIKUAR SI EKSPERT KONTABËL TË LICENSUAR (AUDITUES LIGJOR) PËR**  
**AUDITIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA DHE SHPENZUARA NGA PARTITË**  
**POLITIKE PËR VITIN KALENDARIK 2023**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përmes këtij njoftimi, bën thirrje publike për shfaqje interesi për të qenë ekspert kontabël të licensuar (auditues ligjor) për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2023.

Ekspertët kontabël të licensuar (audituesit ligjor), përveç kushteve të përgjithshme të ushtrimit të profesionit të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duhet të plotësojnë njëkohësisht edhe kriteret e mëposhtme:

- a. Të ushtrojnë profesionin e ekspertit kontabël të licensuar (audituesit ligjor) për jo më pak se 5 (pesë) vitet e fundit;
- b. Të mos kenë marrë masa disiplinore në fuqi;
- c. Të mos jenë anëtar të ndonjë partie politike në 5 (pesë) vitet e fundit;
- d. Të mos kenë qenë kandidat të mbështetur nga ndonjë parti politike, koalicion apo kandidat i propozuar nga zgjedhësit në 2 (dy) zgjedhjet e fundit;
- e. Prindërit, bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët madhor të mos jenë anëtarë të partisë politike objekt i auditimit.

Aplikantët duhet të dorëzojnë brenda datës 05.04.2024 në mënyrë elektronike në email-in [Krist.Puleri@kqz.gov.al](mailto:Krist.Puleri@kqz.gov.al) ose fizikisht pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dokumentat si më poshtë vijon:

- a. Kopje të noterizuar të licencës të ekspertit kontabël të licensuar (auditues ligjor), lëshuar nga IEKA, e vlefshme për vitin kalendarik respektiv;
- b. Vërtetim nga IEKA që vërteton se eksperti kontabël i licensuar (audituesi ligjor) ka jo më pak se 5 (pesë) vite eksperiencë dhe se nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- c. Fotokopje të dokumentit të identifikimit;
- d. Deklaratë vetjake se nuk është në kushtet e parashikuara në shkronjat “c” dhe “d” të sipërcituara, sipas formatit të miratuar në shtojcën 1 bashkëlidhur udhëzimit nr. 14, datë 9.6.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga

partitë politike gjatë viti kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”;

- e. Raport mjeko-ligjor;
- f. Vërtetim të gjendjes gjyqësore.

Pas përfundimit të periudhës së aplikimit, sektori përgjegjës për verifikimin e aplikantëve që dorëzojnë dokumentacionin realizon, brenda 5 (pesë) ditëve, verifikimin e plotësimit të kriterëve formale të sipërcituara. Pas verifikimit dhe përzgjedhjes së aplikantëve që plotësojnë kriteret e sipërcituara Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nxjerr njoftimin për hedhjen e shortit për përzgjedhjen e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesit ligjorë), të cilët do të auditojnë fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2023.